

Mbështetje për menaxhimin e veprimtarisë kërkimore

Rritja e cilësisë së veprimtarisë kërkimore përmes COBISS-it

Pasi u afirmua si kërkues i suksesshëm shkencor në Institutin “Jožef Stefan”, **dr. Franci Demšar** vazhdoi karrierën e tij si sekretar shteti në Ministrinë e Shkencës dhe Teknologjisë. Më vonë ai u emërua ministër i Mbrojtjes i Republikës së Sllovenisë dhe më pas ambasador i Sllovenisë në Rusi. Që nga viti 2004, Franci Demšar është drejtor i Agjencisë Kërkimore Sllovene. Në nëntor të vitit 2013, libri i tij i titulluar “**Transparenca dhe shqetësimi për paratë e taksapaguesve**” u botua nga shtëpia botuese “**Mladinska knjiga**” në seritë Premiki. Midis të tjerave, libri demonstroi qartë mënyrën se si COBISS ka ndikuar në rritjen e produktivitetit të kërkuesve shkencorë dhe në rritjen e cilësisë së veprimtarisë kërkimore në Slloveni.

DISA PJESË NGA LIBRI

Hyrje

Isha emëruar ministër i Drejtësisë për pak më shumë se një muaj kur shefi i zyrës më befasoi me një pyetje rreth kostove të argëtimit. Kostot e argëtimit për stafin drejtues në ministri ishin jashtëzakonisht të larta. - Shumë të larta - tha ai. - Si ka mundësi - mendova me vete; në muajin e parë kur fillova këtë punë, kam qenë shumë i zënë sa që nuk kam patur kohë të ftoj dikë për drekë, le pastaj të organizoja ndonjë aktivitet zyrtar të shtrenjtë. Shefi i zyrës, sigurisht që nuk e dinte këtë, por për të ishin të njohura faturat, të cilat tregonin se për zyrën çdo muaj ishin porositur tetëdhjetë shishe uiski. Vetëm nëse ministria kishte qilarë sekretë të ngjashëm me magazinat e “Fructal”, të fshehur diku dhe uiski nuk ishte porositur për tu ruajtur për kohë të vështira ose për raste të veçanta, por me sa dukej, këto tetëdhjetë litra uiski në të vërtetë ishin konsumuar në një muaj. Kishte shumë të ngjarë që uiski të mos ishte pirë nga stafi drejtues në ministri, të cilëve nuk u lejohej të konsumonin alkool gjatë orarit të punës, dhe nuk kishin kohë të lirë të mjaftueshme për të pirë gjithë atë sasi, në të kundërtën ata do të takonin së shpejti prodhuesin e uiskit. Që ata të furnizonin me uiski të afërmit nuk kishte gjasa, por dyshoja se dikush (që ishte disi kompetent dhe i përmbytur) merrte rryshfet të tillë. Sido që të jetë, diçka nuk shkonte, ndërsa shefi i zyrës pranoi përfundimisht, se ky veprim i kalon të gjithë kufinj.

- Zot, më ndihmo - mendova me vete, ‘nëse kjo shtëpi është më e çmendur nga sa duket, mbase duhet të filloj masat disiplinore kundër personave të përfshirë, në këtë mënyrë ata do të humbasin punën, dhe pastaj në vend të tyre të rekrutoj disa studentë të vitit të parë që studiojnë për komunikim; mbase do jetë më e lehtë kështu’. Këta persona kishin punuar aty për vite me radhë. Ata kishin familje, për të mos përmendur njohuritë dhe eksperiencën në punë, e cila është po aq e rëndësishme sa mendimi pozitiv dhe vendimet e mençura. U mendova mirë dhe mora një vendim të matur, që përfshirja e bordit disiplinor dhe largimi i stafit nga puna për këtë qëllim nuk do të kishte kuptim. Megjithatë, diçka duhej bërë, por me masa më pak radikale. Është e trishtueshme por e vërtetë që njerëzit bëhen më të pakujdesshëm kur ata mendojnë se askush nuk i shikon. Prandaj vendosa, që së bashku me shefin e zyrës, të përgatit një formular të thjeshtë, që ia bënte të ditur stafit në mënyrë të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, se dikush po i vëzhgonte gjatë orarit të punës. Ne përgatitëm një formular të vetëm për sa i përkiste kostove të argëtimit, të cilin administratorët ua jepnin mbikqyrësve të tyre për të shënuar saktësisht se çfarë u duhej atyre për muajin tjetër për aktivitete të ndryshme.

Duke bërë këtë, çdokush do të shihte se çfarë kishin shkruar të tjerët, dhe çuditërisht as edhe një shishe e vetme uiski nuk u porosit në muajin e parë. Kjo tendencë mospirjeje vazhdoi edhe në muajt në

vijim. Askush nuk përmendi se diçka kishte ndryshuar, dhe deri më sot, ende pyes veten nëse ata kuptuan se ky formular ishte në fakt ideja ime. Në të vërtetë, unë nuk ndërmora masa të reja, por vetëm përdora mekanizmin e transparencës dhe rezultatet ishin të befalshme. Kur njerëzit kuptojnë se ata nuk janë më vetëm por se sjellja e tyre është publike, ata fillojnë të veprojnë ndryshe.

Kjo është përmbajtja e librit.

Viti vendimtar

Pas një analize të hollësishme të sistemit kombëtar dhe politikës shkencore në vitin 1998, vit vendimtar, arrita në konkluzionin e mëposhtëm: pikërisht para ndryshimit në punën e kërkuesve më 1997, në Slloveni u prezantua një risi e rëndësishme institucionale, e cila gjithashtu, edhe pse dukej pa eksperiencë, solli një publikim më aktiv të shkencëtarëve sllovenë. COBISS, i cili sot pothuajse merret si i mirëqenë, nuk ka shumë kohë që është krijuar, dhe është prezantuar si strukturë e detyrueshme në vitin 1997. Unë personalisht besoj se ky ndryshim inkurajoi kërkuesit sllovenë të bënin më shumë përpjekje për botimin e punëve të tyre. Zbatimi i COBISS-it ndodhi me një dozë të mirë relativizmi, e cila mbizotëroi edhe në sferën akademike. Papritur “vlëra” e një shkencëtari u bë më e prekshme. Bazuar në rishikimin e artikujve të botuar shkencorë, COBISS mundësoi një vlerësim të shpejtë, transparent dhe të besueshëm të rëndësisë së shkencëtarëve në fushën e tyre të punës.

Sot, cilido që është i interesuar, qoftë ai ekspert apo person i zakonshëm, mund të shoh se çfarë, sa dhe si punojnë kërkuesit shkencorë. Për arsye të këtij niveli ekspozimi ndaj “mbikqyrjes” nga kolegët dhe publiku i zakonshëm, interesi i kërkuesve për botimin e punëve të tyre në revista shkencore me emër, u rrit në mënyrë të konsiderueshme dhe për të njëjtën arsye, kërkuesit shkencorë sllovenë filluan të kërkojnë në mënyrë aktive mundësi për të marrë pjesë në projekte kërkimi ndërkombëtare.

Zbatimi i sistemit COBISS shkaktoi një revolucion të vogël, veçanërisht lidhur me qëndrimin e kërkuesve ndaj publikimeve të tyre, por edhe ndaj vlerësimit shkencor të punëve të tyre. Kur isha Sekretar Shteti dhe Ministër i Shkencës dhe Teknologjisë, habitesha kur shihja mospërputhje midis vlerësimit tim për cilësinë e kërkuesve të caktuar dhe bartësve të projekteve kërkimore. Një veçanti e sistemit të atëhershëm shkencor dhe kërkimor ishte fakti se, kërkuesit më cilësor nuk kanë qenë domosdoshmërisht edhe udhëheqës i projekteve kërkimore. Përveç kësaj habitesha edhe nga fakti që karrierat akademike disave ju serviroshin në pjetë, me sa duket pa ndonjë referencë shkencore përkatëse, ndërsa të tjerët edhe pse kishin një numër të konsiderueshëm botimesh nuk mund të ecnin në karrierat e tyre, pavarësisht bibliografive impresionuese. Fatmirësisht fillova të punoj në ministri pikërisht në kohën kur po zbatohesh sistemi COBISS dhe besova se sistemi mund të na ndihmonte për të zgjidhur këtë problem. Ndryshova rregullat e lojës duke theksuar se për aplikimet në projekte kërkimi dhe zhvillimi, komisionet speciale do të merrnin në konsideratë vetëm ato bibliografi që ishin të disponueshme online dhe të organizuara sistematikisht në sistemin COBISS.

Regjistrimi i detyrueshëm i bibliografive të kërkuesve shkencorë në COBISS, si bazë për vlerësimin dhe financimin, së bashku me mjete të reja informacioni, çoi në disa ndryshime të spikatura në natyrën dhe qëllimin e botimit. Meqënëse kërkuesit mund të aplikojnë në projekte duke përdorur vetëm punët e përfshira në sistemin COBISS, baza e të dhënave përditësohej shumë shpesh. Vetëm në tre muaj, numri i hyrjeve në bazën e të dhënave u rrit njëzetë herë; dhe sot kërkuesit sllovenë kanë më shumë se dy milion regjistrime në COBISS.

Prezantimi i një sistemi transparent për ndarjen e të dhënave, në të cilin informacioni hidhet në mënyrë të standardizuar dhe në një formë të përcaktuar dhe gjithëpërfshirëse, mundësoi pasqyrimin e punës së kërkuesve dhe krijoi marrëdhënie më reale brenda vet komunitetit kërkimor. Meqënëse sistemi u mbështet nga programe online të kohëve të fundit, ai lejoi këdo të shihte produktet shkencore të kolegëve të tyre. Natyra e hapur e informacionit rriti interesin e shkencëtarëve për të botuar punimet në revista më të mira sepse rezultatet e tyre nuk do të mund të anashkaloheshin këtej e tutje – transparenca jo vetëm nxjerr në dritë defektet por edhe cilësitë. Të gjitha këto i kontribuan faktit se në vend të përdorimit të kriterëve jo të qarta në renditjen e individëve, kriterë kryesore u bënë rezultatet e tyre në fushën e shkencës dhe kërkimit, që nënkuptonte, se renditja e kërkuesve në nivelin e përsosmërisë shkencore është shumë më reale sot sesa në të kaluarën.

Transparenca e botimeve në rrethet shkencore dhe kërkimore pati gjithashtu shumë efekte të tjera pozitive. Gradualisht u prezantuan procedura të reja që vlerësonin rezultatet e kërkimit të kandidatëve në mënyrë më konsistente. Sigurisht që “trajtimi i privilegjuar” në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve nuk u zhduk plotësisht, por të paktën u zvogëluar në një farë mase. Nga ana tjetër, ministria që ishte kompetente për shkencën në atë kohë dhe më vonë Agjencia Kërkimore e Sllovenisë filluan të prezantojnë procedura më të mira vlerësuese për përzgjedhjen e bartësve dhe ekzekutuesve të projekteve shkencore e kërkimore. Sistemi i ri i vlerësimit i cili u krijua edhe si rezultat i COBISS-it, ndryshoi marrëdhëniet brenda institucioneve shkencore. Ky sistem solli një ndryshim të shpejtë të brezave dhe për këtë arsye, sot kërkuesit sllovenë janë ndër më të rinjtë në Evropë, si dhe kontriboi për pjesmarrjen e një numri më të lartë të grave në fushën e shkencës dhe kërkimit.

Pas krijimit të sistemit COBISS, pozicioni i kërkuesve dhe vlerësimi i përsosmërisë së tyre shkencore nuk mund të bazohet në kriterë të pjesshme ose të paqarta, por në të dhëna cilësore, standarde dhe të besueshme. Sot bibliografia e një kërkuesi mund të shihet nga të gjithë – partnerë të mundshëm kërkimorë si dhe studentë. Meqë cilësia (dhe sasia) e punimeve të botuara mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në vendimin për të bashkëpunuar ose (për studentët) për zgjedhjen e udhëheqësve të tyre, botimet shkencore më nuk merren lehtë në Slloveni.

Sistemi i transparencës që u prezantua solli rezultate të rëndësishme dhe konkrete. Sllovenia, e cila ka të njëjtat kushte hyrjeje, si burimet e disponueshme financiare, numrin e kërkuesve shkencorë dhe shumëllojshmërinë e marrëdhënieve ndërkombëtare me vende të tjera në rajon, gëzon një përparësi të rëndësishme mbi të tjerët si rezultat i këtij sistemi. Transparenca i inkurajon kërkuesit sllovenë të arrijnë rezultate të mira, për të cilat ata vlerësohen me njohje publike, meqënëse rezultatet e tyre kërkimore janë të disponueshme për publikun e gjërë, falë këtij sistemi informacioni.

Koha për numra

Sistemi ngjan shumë me shembullin e uiskit që përmenda më parë, vetëm monedha është e ndryshme. Duke patur parasysh që uiski dhe përsosmëria shkencore kanë pak gjëra të përbashkëta dhe për këtë arsye janë të vështira për t'u krahasuar, le t'i ndryshojmë ato në një monedhë me të cilën jemi familjarizuar të gjithë. Duke vendosur transparencën kur porositet për nevojat e punonjësve në ministri, ne kursyem 700 euro vetëm për uiski, që është një shifër mjaft e lartë. Kur ndajmë para për kërkime shkencore në nivel kombëtar, flasim për disa qindra miliona euro në vit, që duhen shpenzuar në mënyrë sa më efektive. Figura 5 tregon rritjen e pritshme dhe aktuale të botimeve të kërkuesve sllovenë nga viti 1993 deri në vitin 2007. Figura tregon se në vitin 2007 kur buxheti i Agjencisë Kërkimore Sllovene ishte afërsisht 160,000,000 euro, nëse do të vazhdonte sistemi i mëparshëm i publikimit, Agjencia Kërkimore do të humbiste rreth 4,000 publikime shkencore përmes financimit të projekteve. Thënë ndryshe, duke

pasur parasysh sistemin e mëparshëm, me qëllim që të arrihej numri aktual i botimeve për vitin 2007, buxheti duhet të kishte vlerën 260,000,000 euro. Duke i parë gjërat nga këndvështrimi i taksapaguesve, që është bërë popullore vitet e fundit në Slloveni dhe kudo në botë, ne mund të themi me siguri se duke prezantuar transparencën në fushën e kërkimit shkencor, kursyem 100,000,000 euro nga paratë e taksapaguesve vetëm për vitin 2007. Përveç kësaj, nëse në vitin 1997 nuk do të kishte patur ndryshim në produktivitetin e kërkuesve dhe ne do të donim të arrinim një numër më të lartë të botimeve në revistat shkencore, fondet duhej të rriteshin çdo vit. Kjo do të thotë se në vitin 1999, për kërkime shkencore duhet të siguroheshin 5,000,000 euro (afërsisht); në vitin 2000, numri do të ishte rritur në 17,000,000 euro, vitin në vazhdim në 28,000,000 euro, dhe një vit më vonë në 40,000,000 euro. Në vitin 2003 nga buxheti kombëtar duhet të akordoheshin 52,000,000 euro për të arritur rritjen aktuale të botimeve; në vitin 2004, numri do të duhet të rritej në 63,000,000 euro dhe në vitin 2005, do të shkonte në 75,000,000 euro. Në vitin 2006, kërkuesit përdorën 86,000,000 euro më pak se sa do të kishin përdorur me sistemin e vjetër, dhe nëse ju i shtoni këtij numri 100,000,000 euro nga viti 2007, taksapaguesit do jenë në gjendje të marrin frymë lirisht kur të mësojnë se brenda 9 vjetësh (pa vënë në rrezik cilësinë ose sasinë), Agjencia Kërkimore Sllovene ishte në gjendje t'u kursente atyre disa miliona euro.




Figura 5 Rritja e akumuluar e numrit të artikujve sllovenë në bazën ndërkombëtare të të dhënave Web of Science në periudhën pas vitit 1993. Figura tregon buxhetin e Agjencisë Kërkimore Sllovene për vitin 2007 (160,000,000 EUR) dhe numrin e miliona eurove që do të duheshin për të mbajtur në rritje numrin e botimeve shkencore vetëm duke siguruar fonde shtesë për buxhetin.

Mbase ky interpretim është pak i thjeshtuar, por megjithatë, mund të them me siguri se pa zbatimin e sistemit COBISS në vitin 1997 dhe futjes së detyrueshme të punimeve shkencore dhe profesionale në të, kishte shumë të ngjarë të mos kishte rritje të produktivitetit shkencor. Në çdo rast, rritja do të vazhdonte me ritmin e mëparshëm, që do të thotë se niveli i produktivitetit shkencor i vitit 2007 do të arrihej jo më parë se viti 2016. Kështu që, me zbatimin e COBISS-it, të cilit nga buxheti i akordohen afërsisht një milion euro në vit për shërbime të infrastrukturës shkencore, u kursyen të paktën nëntë vite financime për shkencën, që në total shkojnë në mbi një miliard euro. Dhe kjo shumë është një sasi e madhe uiski.